

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUCIONIN E PRESIDENCËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në ***Institucionin e Presidencës*** me objekt: “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar, për periudhën 1/1/2010 deri me 31/12/2011” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 108, datë 30/06/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 428/6, datë 30/06/2012 dërguar **Z. Aleksander Flloko, Sekretar i Pergjithshëm i Institucionit të Presidencës**, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Me qëllim që vizitat jashtë shtetit të personaliteteve të larta shtetërore, apo të punonjësve të tjerë të jenë të rregullta e të plota, në të gjitha rastet, kopjet e ftesave të palëve pritëse të përkthyer, të jenë pjesë e praktikës së urdhër-shpenzimeve përkatëse.

Vazhdimisht

2. Institucioni i Presidentit të Republikës, në të ardhmen të marrë masat e duhura që, për të gjitha dhuratat dhe dekoratat që blihen nga operatorë të ndryshëm dhe që në përbërje të tyre kanë përmbajtje ari, argjendi, apo metale të tjera të çmuara të përcaktojë përmbajtjen e metalit të çmuar në çdo porosi dhe të kërkojë që çdo blerje të shoqërohet me certifikatë origjine dhe cilësie.

Vazhdimisht

3. Me qëllim përmirësimin e zbatimit të procedurave të prokurimit me fonde publike **rekomandojmë që:**

a) Institucioni i Presidentit të marrë masat e duhura që në të ardhmen për blerjen e karburantit, të zbatohen procedurat e prokurimit “Tender i Hapur”, me qëllim eliminimin e mangësive të konstatuara gjatë zhvillimit të tenderëve me procedurë prokurimi “Kërkesë për Prokurim”, të zgjedhur nga Autoriteti Kontraktor.

b) Planifikimi i nevojave për punë, mallra dhe shërbime të bëhet i saktë dhe mbi bazën e studimeve të çmimeve të tregut, sipas afateve të kërkuara, normativave të konsumit dhe përdorimit.

c) Riparimet dhe shërbimet e planifikuara të automjeteve, të kryhet pasi të jenë nxjerrë të dhënat e përdorimit të mjeteve, kilometrat e përshkruara, koha e përdorimit, kushtet teknike.

Vazhdimisht

4. Për përmirësimin e mjedisit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e riskut, rekomandojmë që:

a) Njësia me miratimin e deklaratës së misionit, objektivave dhe të strategjisë, të marrë masa për të bërë të mundur dokumentimin për njohjen e punonjësve me përmbajtjen e saj.

b) Njësia të marrë masa për miratimin e strategjisë së politikave, e cila të përmbajë objektivat strategjike, prioritet e institucionit dhe planet e veprimit.

c) Njësia të bëjë të mundur hartimin e procedurës për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

d) Njësia të marrë masa për të kryer vlerësime periodike të punonjësve lidhur me detyrat që ata kryejnë.

e) Njësia të marrë masa që për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, të hartojë programe specifike për trajnimin e tyre.

f) Njësia të marrë masa që në të ardhmen të hartojë strategjinë e riskut të dokumentuar dhe të miratuar.

Menjëherë

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Aleksander Tereziu Përgjegjës Grupi, Pjeter Beleshi dhe Vasil Vane. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit zj. Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Juristi i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Koço Sokoli (në mungesë të Drejtorit Drejtorisë dhe me porosi), si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT